

VENDIM
Nr. 599, datë 13.10.2021

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË,
ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE
DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE BASHKIMIT TË SHOQËRIVE (JV),
“MARINA DI VALONA” SHPK, ME NUIS M01324008A, “BRUNES” SHPK, ME
NUIS K37125203H, “NDREGJONI” SHPK, ME NUIS K31329048I, DHE “MARINA
PROJECTS” LTD, ME NUMËR REGJISTRIMI 04182366, SI QIRAMARRËS, PËR
PASURINË SHTETËRORE, PJESË E FONDIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të nenit 27, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 (një) euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe Bashkimit të Shoqërive (JV), “*Marina di Valona*” sh.p.k., me NUIS M01324008A, “Brunes” sh.p.k., me NUIS K37125203H, “Ndregjoni” sh.p.k., me NUIS K31329048I, dhe “*Marina Projects*” LTD, me numër regjistrimi 04182366, si qiramarrës, për pronën e paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 8602, Bashkia Vlorë, pjesë e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike, sipas dokumentacionit të pronësisë, planvendosjes, listës së pasurive dhe tekstit të projektkontratës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë dhe Bashkimi i Shoqërive (JV), “*Marina di Valona*” sh.p.k., me NUIS M01324008A, “Brunes” sh.p.k., me NUIS K37125203H, “Ndregjoni” sh.p.k., me NUIS K31329048I, dhe “*Marina Projects*” LTD, me numër regjistrimi 04182366, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

Nr. _____ Rep.

Nr. _____ Kol.

KONTRATË QIRAJE
Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata

“Kontrata”, nënshkruhet në Tiranë, sot më datë _____.____.2021 (në vijim “Data e kontratës”), përpara meje [●], noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë rruga [●], dhe ndërmjet:

Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar me autorizim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. prot., datë _____.2021, nga _____, i datëlindjes _____, banues në _____, me shtetësi shqiptare, i pajisur me kartën e identitetit me nr. personal _____, që më poshtë do të quhet **QIRADHËNËS**.

Dhe

Bashkimit të Shoqërive (JV), “*Marina di Valona*” sh.p.k., me NUIS M01324008A, “Brunes” sh.p.k., me NUIS K37125203H, “Ndregjoni” sh.p.k., me NUIS K31329048I, “*Marina Projects*” LTD, me numër regjistrimi 04182366, përfaqësuar sipas prokurës së posaçme nr. rep. ____ dhe kol.____, datë _____ nga z. **Andi Pashaj**, identifikuar me letërnjoftimin personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet **QIRAMARRËS**.

Meqenëse:

Bashkimi i Shoqërive (JV), “*Marina di Valona*” sh.p.k., me NUIS M01324008A, “Brunes” Sh.p.k., me NUIS K37125203H, “Ndregjoni” sh.p.k., me NUIS K31329048I, “*Marina Projects*” LTD me numër regjistrimi 04182366 është fitues i Koncesionit në Portin Vlorë.

Në shtesë të investimeve që do bëjë në lidhje me Koncesionin, Qiramarrësi planifikon të investojë, nëpërmjet një subjekti për qëllime të veçanta të krijuar për këtë qëllim, edhe disa struktura shërbimesh dhe struktura mbështetëse me fokus turizmin, si dhe ngritjen e disa ndërtimeve me natyrë civile, komerciale apo akomoduese.

Bazuar në ligjin nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Investitori aplikoi pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (në vijim “AIDA”) për marrjen e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë” të Projektit të Investimit “*Marina di Valona*”, duke kërkuar ndërmjet të tjerave përfshirjen e shtetit shqiptar në investimin strategjik, nëpërmjet vënies në dispozicion të Pronës sipas planit të rievimit, dhe dokumentacionit të pronësisë. Sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), nëpërmjet vendimit nr. 4/3, datë 29.3.2021 miratoi pjesëmarrjen shtetërore në këtë investim strategjik, si dhe vendosi që t’i japë investitorit të Investimit Strategjik statusin e “investimit/investitorit strategjik, procedurë e veçantë”.

Në zbatim të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 i ndryshuar, vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 4/3, datë 29.3.2021, Autoriteti Kontraktues nëpërmjet kësaj kontrate vendos në dispozicion të Investitorit, pronën në përputhje me kushtet dhe përcaktimet e bëra në këtë kontratë.

Në këmbim të marrjes në përdorim të pronës, investitori do të ndërtojë, zhvillojë dhe operojë disa struktura shërbimesh dhe struktura mbështetëse, me natyrë civile, komerciale apo akomodues, (me fokus turizmin) në përputhje me Projektin dhe planin e investimit të miratuar nga Komiteti i Investimeve Strategjike.

Baza ligjore e kontratës, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, ligji nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimi nr. 54, datë 5.2.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 4/3, datë 29.3.2021 dhe neneve 801–825, të Kodit Civil.

Neni 1

Objekti i kontratës

1.1 Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë shtetërore përkatësisht: nr. pasurie 28/55 truell me sipërfaqe 173 m², nr. pasurie 28/17 truell me sipërfaqe 177 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 177, nr. pasurie 28/36/2 me sipërfaqe truell 1405 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 1405 m², nr. pasurie 28/57 me sipërfaqe truell 43 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 43 m², nr. pasurie 28/58 me sipërfaqe truell 1382 m², nr. pasurie 28/59 me sipërfaqe truell 581 m², nga ku

sipërfaqe ndërtimore 581 m², nr. pasurie 28/60 me sipërfaqe truall 55 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 55 m², nr. pasurie 28/61 me sipërfaqe truall 35 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 35 m², nr. pasurie 28/67/2/1 truall me sipërfaqe 241 m², nr. pasurie 28/68 truall me sipërfaqe 33 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 33 m², nr. pasurie 28/69 me sipërfaqe truall 80 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 80 m², nr. pasurie 28/70 me sipërfaqe truall 43 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 42.65 m², nr. pasurie 28/73/4 truall me sipërfaqe 1284 m², nr. pasurie 28/73/6 truall me sipërfaqe 26736 m², nr. pasurie 28/73/8 truall me sipërfaqe 5174.5 m², nr. pasurie 28/73/9 truall me sipërfaqe 3038.5 m², nr. pasurie 28/74/2 me sipërfaqe truall 353.2 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 353.2 m², nr. pasurie 28/105 truall me sipërfaqe 1875 m², nr. pasurie 28/106/2 truall me sipërfaqe 11317.3 m², nr. pasurie 28/106/3 truall me sipërfaqe 401 m², nr. pasurie 28/66 me sipërfaqe truall 560 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 560 m², nr. pasurie 28/72 truall me sipërfaqe 465 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 465 m², nr. pasurie 28/65/2 truall me sipërfaqe 589 m², nr. pasurie 28/65/3 truall me sipërfaqe 1461 m², **e përcaktuar si sipërfaqe totale truall 57.502.5 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 3829.85 m², Z.K. nr. 8602 Bashkia Vlorë**, sipas genplanit dhe dokumentit të pronësisë lëshuar nga ASHK-ja dhe draft kontratës miratuar me VKM-në nr. _____, datë _____, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si qiradhënës dhe Bashkimit të Shoqërive (JV) “*Marina di Valona*” sh.p.k., me NUIS M01324008A, “Brunes” sh.p.k., me NUIS K37125203H, “Ndregjoni” sh.p.k., me NUIS K31329048I dhe “*Marina Projects*” LTD me numër regjistrimi 04182366 si qiramarrës, për pronën e paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 8602 Bashkia Vlorë, pjesë e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike”, sipas dokumentacionit të pronësisë, planvendosjes, listës së pasurive dhe tekstit të kontratës që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim ndërtimin e disa strukturave shërbimesh dhe struktura mbështetëse me fokus turizmin, si dhe për ngritjen e disa ndërtimeve me natyrë civile, komerciale për zhvillimin e turizmit në këtë zonë.

Neni 2 Qëllimi i përdorimit

2.1 Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, që do të konsistojë në ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës “Pro turizmi”, duke investuar rreth **9,811,904,094** (nëntë miliard e tetëqind e njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e katër mijë, e nëntëdhjetë e katër) lekë **pa TVSH** dhe duke punësuar minimalisht **100 punonjës**.

Neni 3 Kohëzgjatja

3.1 Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë **20 (njëzet) vjet** dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 “Qiradhënësi”, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës që është Agjencia e Zhvillimit të Investimeve Strategjike, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t’u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 “Qiradhënësi” ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e “Qiramarrësit”.

4.3 “Qiradhënësi” ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësive monitoruese të kontratës së qirasë, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 “Qiradhënësi” është i detyruar të garantojë “Qiramarrësin” për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë. Qiradhënësi nuk mban asnjë përgjegjësi ligjore për problematikat që mund t'i lindin qiramarrësit gjatë ezaurimit të kontratës, me pronat private kufitare me pasuritë objekt kontrate. Çdo lloj pretendimi nga të tretë, do të zgjidhet nga vetë qiramarrësi, duke përjashtuar Qiradhënësin, nga çdo lloj detyrimi apo pasoje të mundshme.

4.5 “Qiradhënësi” ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur “Qiramarrësi” shkel detyrimet e marra përsipër, pa shkaqe të arsyeshme duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 “Qiradhënësi” nuk është i detyruar të garantojë “Qiramarrësin” nga shqetësimet e të tretëve që pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 “Qiramarrësi” ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 “Qiramarrësi” ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

5.3 “Qiramarrësi” detyrohet që në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan biznesin pjesë integrale e kësaj kontrate.

5.4 “Qiramarrësi” detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 “Qiramarrësi” detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 “Qiramarrësi” detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 “Qiramarrësi”, në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate do të investojë për të ngritur aty kompleks me infrastrukturë “Pro turizmi”, me qëllim dhe në funksion të ushtrimit të veprimtarisë në fushën e turizmit, si dhe për ngritjen e disa ndërtimeve me natyrë civile, komerciale apo akomoduese.

5.8 Totali i vlerës së investimeve në pasurinë shtetërore, sipas planbiznesit është rreth **9,811,904,094 (nëntë miliardë e tetëqind e njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH**, dhe do të përfundojë brenda **72 muajve** nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjeve të lejeve përkatëse për punimet. Sipas planbiznesit të paraqitur, ky investim do të realizohet si vijon:

- faza e parë paraprake përbëhet nga parkimi nëntokësor i zonës C dhe parcelat e ndërtimit direkt mbi këtë parkim (ngjyra e purpurt e errët), si dhe parcelat D3 dhe D4 për të kompletuar strukturën ekzistuese urbane;

- faza e dytë paraprake përfundon programet specifike të lidhura me marinën (A1 dhe D1), si dhe pasuritë e patundshme kryesore të bregdetit (zona B), parkimin nëntokësor dhe hotelin e parë nga dy hotelet e parashikuar;

- faza e fundit e planifikuar parashikon në dorëzimin e hotelit të dytë, si dhe bllokut shoqërues B1 dhe parcelës D5.

Viti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6
Volumi i punimeve në përqindje	15%	20%	15%	15%	25%	10%
Volumi i punimeve në vlerë monetare	1,471,785,633	1,962,380,843	1,471,785,633	1,471,785,633	2,452,976,054	981,190,422

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të investimeve të parashikuara, transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

5.9 “Qiramarrësi”, sipas parashikimit për realizimin e investimit dhe punësimin të shprehur në plan biznesin e paraqitur, investimi, do të realizohet brenda **72 muaj** nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse, dhe do të punësojë minimalisht **100 punonjës**. Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimin të parashikuar transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij. “Qiramarrësi detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

5.10 “Qiramarrësi”, në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër sipas neneve 5.7, 5.8, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe autorizime të posaçme nga organet kompetente.

5.11 “Qiramarrësi” detyrohet të paraqesë te “Qiradhënësi” në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga Audituesi, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.12 “Qiramarrësi” detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.13 “Qiramarrësi” në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. “Qiradhënësi” nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga “Qiramarrësi”.

5.14 Në ngarkim të “Qiramarrësit” janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.15 “Qiramarrësit” nuk i lejohet, që pronën e dhënë me qira ta japë me nën qira ose t’ia kalojë kontratën një tjetri.

5.16 “Qiramarrësi” në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt të kësaj kontrate.

Neni 6

Pagesa e qirasë

6.1 “Qiramarrësi” detyrohet t’i paguajë “Qiradhënësit” detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro.

Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata, sipas faturës të lëshuar nga “Qiradhënësi”.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës “Qiramarrësi” detyrohet të paguajë garancinë e kontratës, në vlerën 2% të vlerës së investimit të marrë përsipër sipas plan biznesit, në një nga format e garancisë bankare/kompani sigurimi, e cila qëndron e ngurtësuar për llogari të qiradhënësit deri në përfundim të investimit.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, “Qiramarrësi” do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e “Qiradhënësit” sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7

Penalitetet

7.1 Në rastin kur “Qiramarrësi”, sipas përcaktimeve në pikën 5.8, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën **10 për qind të vlerës së investimit të porealizuar**. Nëse, pas 6 muajve investimi vazhdon të mos realizohet,

“Qiradhënësi” zgjidh kontratën dhe sanksionon “Qiramarrësin” me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, “Qiramarrësi” nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.10, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën **50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë** për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

- a) në marrëveshje midis palëve;
- b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;
- c) kur “Qiramarrësi” shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 5 dhe 6 të kësaj kontrate;
- d) kur “Qiramarrësi” ndryshon destinacionin për të cilin është lidhur kontrata;
- e) kur prona nevojitet për interes publik;
- f) kur prona kalon në procedurë privatizimi.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 30 ditë pas njoftimit me shkrim të “Qiradhënësit” për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse “Qiramarrësi” nuk ka reaguar me shkrim. Qiramarrësi detyrohet të dorëzojë objektin, 15 ditë pas marrjes së njoftimit me shkrim të “Qiradhënësit” për zgjidhjen e kontratës.

8.4 Palët bien dakord dhe marrin përsipër të bëjnë çdo përpjekje, që për çdo çështje të lidhur me përmbushjen e kësaj kontrate apo edhe me të gjitha elementet e vlefshmërisë dhe interpretimit të saj, ta zgjidhin me marrëveshje midis tyre. Në këtë rast çdo ndryshim do të pasqyrohet formalisht me shkrim dhe mbas nënshkrimit do të konsiderohet pjese integrale e kësaj kontrate.

8.5 Palët bien dakord dhe japin miratimin që çdo konflikt, mosmarrëveshje pretendim, ndryshim ose kontraditë që lind nga ose në lidhje me, ose që ka lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë çdo mosmarrëveshje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë, interpretimin, realizimin, shkeljen ose përfundimin e kësaj kontrate, ose me pasojat e pavlefshmërisë së saj, duke përfshirë çfarëdo detyrimi jokontraktual që lind nga/ose në lidhje me këtë kontratë (një “Mosmarrëveshje”), do të zgjidhet përfundimisht me anë të Arbitrazhit në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare së Tregtisë (*ICC Rules*), në fuqi në atë kohë. Numri i arbitrave do të jetë tre (“Gjykata e Arbitrazhit”). Paditësi (ose paditësit bashkërisht) do të caktojnë një arbitër. I padituri (ose të paditurit bashkërisht) do të caktojnë një arbitër. Kryetari do të caktohet bashkërisht nga dy arbitra të emëruar nga Palët, brenda 20 ditësh nga emërimi i arbitrit të dytë.

8.6 Vendi i arbitrazhit do të jetë Vjena, Austri. Gjuha e përdorur në procedurat e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze dhe vendimi do të shkruhet në gjuhën angleze. Të gjitha dokumentet e paraqitura në lidhje me procedurat do të jenë në gjuhën angleze ose, nëse janë në gjuhë tjetër, do të jenë të shoqëruara nga përkthimi në gjuhën angleze.

8.7 Gjykata e Arbitrazhit do të ketë autoritetin për të marrë në konsideratë dhe për të përfshirë në çfarëdo procedure ose vendimi çdo Mosmarrëveshje të mëtejshme të paraqitur nga një Palë, por, në varësi të sa më sipër, asnjë palë tjetër ose konflikte të tjera nuk do të përfshihen, ose konsolidohen me procedurën e arbitrazhit.

8.8 Secila prej Palëve bie dakord që vendimi përfundimtar, urdhri ose gjykimi kundër saj në çfarëdo procedure, në bazë të këtij neni do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm ligjërisht për atë Palë dhe mund të zbatohet në gjykatat e Republikës së Shqipërisë apo në çdo gjykatë tjetër në juridiksionin e së cilës bën pjesë ajo Palë, ose ku mund të jetë subjekt nëpërmjet një procesi gjyqësor për urdhër, vendim ose gjykim, një kopje e certifikuar ose e njehsuar e atij urdhri,

vendimi ose gjykimi do të konsiderohet se është evidencë përfundimtare e saj dhe e shumës së detyrimeve të saj, ose me çfarëdo mjeti tjetër të dhënë nga ligji.

Neni 9

Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga “Qiramarrësi”, sipas pikave 5.8, 5.9, të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta me Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit Investimeve (AIDA), për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 “Qiramarrësi” dhe “AIDA” janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me “forcë madhore” do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmytjet, lufta etj. dhe çdo ngjarje e paparashikuar që do të shpallet si e tillë me një akt zyrtar. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 “Qiramarrësi” përjashtohet nga detyrimet kontraktuale për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak dhe afati përmbushjes së detyrimeve do të shtyhet në kohë, për aq kohë sa zgjat edhe forca madhore apo shkak i mospërmbushjes. Kjo periudhë do të përcaktohet saktësisht me marrëveshje midis palëve.

Neni 10

Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t’i referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë Plan Biznesi i miratuar, proces verbal i marrjes në dorëzim të objektit, sipas kontratës së qirasë dhe dokumentacioni i pronës konfirmuar nga ASHK-ja.

10.3 Në rast të mosmarrëveshjeve të lindura mes palëve, autorizohet njësi administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.4 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin, që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

10.5 Nëse shoqëria qiramarrëse do të kryejë investimet e marra përsipër në përputhje me Plan Biznesin e paraqitur dhe pasi shoqëria të ketë respektuar kushtet e kontratës, i lind e drejta e vlerësimit të investimit me qëllim hyrjen në procedurë privatizmi të drejtpërdrejtë të objektit të kontratës, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

11.1 Brenda 1 (një) muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

11.2 Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen “Qiramarrësit”.

11.3 Kjo kontratë është formuluar në 7 (shtatë) kopje origjinale. Pasi ju lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë të nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

QIRAMARRËSI

Shoqëria “Marina Di Valona” sh.p.k.

LISTA E PASURIVE NË DISPOZICION PËR ZHVILLIMIN DHE REALIZIMIN E PROJEKTIT
INVESTUES STRATEGJIK “MARINA DI VALONA”

Nr. rendor	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Sip. totale e pronës	Nga sip. totale: sa ndërtesë
1	8602	28/36/2	truall	1405	1405
2	8602	28/57	truall	43	43
3	8602	28/58	truall	1382	
4	8602	28/59	truall	581	581
5	8602	28/60	truall	55	55
6	8602	28/61	truall	35	35
7	8602	28/65/2	truall	589	
8	8602	28/65/3	truall	1461	
9	8602	28/66	truall	560	560
10	8602	28/69	truall	80	80
11	8602	28/70	truall	43	42.65
12	8602	28/72	truall	465	465
13	8602	28/73/4	truall	1284	
14	8602	28/73/6	truall	26736	
15	8602	28/73/8	truall	5174.5	
16	8602	28/73/9	truall	3038.5	
17	8602	28/74/2	truall	353.2	353.2
18	8602	28/105	truall	1875	
19	8602	28/106/2	truall	11317.3	
20	8602	28/106/3	truall	401	
21	8602	28/17	truall	177	177
22	8602	28/55	truall	173	
23	8602	28/68	truall	33	33
24	8602	28/67/2/1	truall	241	
				57502.5	3829.85

Bashkimi i operatorëve “Marina di Valona” sh.p.k. (NUIS M01324008A); shoqëria “Brunes” sh.p.k. (NUIS K37125203H), shoqëria “Ndrejoni” sh.p.k. (NUIS K31329048I) dhe shoqëria “Marina Projects” sh.p.k. (NUIS 04182366), me Perfaqësues shoqëria “Marina di Valona” sh.p.k, më poshtë “Bashkimi i Operatorëve”.

PLANI I BIZNESIT



Tabele permbledhese

1. Deklarate mbi pergjësine ligjore të vërtetësisë se dokumentacionit
2. Aplikim
3. Plan i Biznesit esenciale
4. Anex i planit te biznesit
5. Plani i investimit dhe burimet financiare
6. Grafiku i punimeve dhe përshkrim referues i objekteve
7. Raporti i përfitimeve dhe niveli i punësimit
8. Raporti Social Mjedisor

Lënda: Biznes Plan

Hartues: Bashkimi i Operatoreve: Shoqëria "Marina di Valona" sh.p.k. (NUIS M01324008A); shoqëria "Brunes" sh.p.k. (NUIS K37125203H), shoqëria "Ndregjoni" sh.p.k. (NUIS K31329048I) dhe shoqëria "Marina Projects" sh.p.k. (NUIS 04182366), me Perfaqesues shoqëria "Marina di Valona" sh.p.k, me poshtë "Bashkimi i Operatorëve".

Drejtuar: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Referencat ligjore: Ligji nr. 55/2015 "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë, Vendim i Këshillit të Ministrave nr 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", Vendim të Komisionit të Investimeve Strategjike nr 4/3 dt. 29.03.2021, Kontratë bashkëpunimi datë 18/02/2021 nr.repertori 728, nr. koleksioni 492.

Te nderuar!

Bashkimi i Operatorëve krijuar sipas kontratës së bashkëpunimit datë 18.02.2021 paraqet pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dokumentacionin e kërkuar në zbatim të akteve ligjore të sipërpërmendura, me qëllim lidhjen e kontratës së qirasë sipas Vendimit të Komisionit të Investimeve Strategjike nr 4/3 dt. 29.03.2021.

Me respekt,

Përfaqësuesi i Bashkimit të Operatorëve

Marina Di Valona shpk

Administratori

Andi Pashaj

ANUS7 PASHAJ



DEKLARATË MBI PËRGJEGJËSINË LIGJORE

Unë i nënshkruari Andi Pashaj në cilësinë e administratorit të “Marina Di Valona” sh.p.k, në referencë të Kontratës së Bashkëpunimit për krijimin e bashkimit të operatorëve bazuar në kompetencat që më përcillen prej kësaj kontrate, (Neni 3..Kryesuesi i bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Marina di Valona” sh.p.k do të përfaqësojë grupimin në të gjitha organet e administratës publike, shtetërore, përpara çdo enti dhe autoriteti tjetër , përpara personave juridikë dhe fizikë privatë) deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore vërtetësinë e të gjithë dokumentacionit bashkengjitur Plani të Biznesit.

“Marina di Valona” sh.p.k

Administratori

Andi PASHAJ

ANDI PASHAJ


MARINA DI VALONA
101324008A

Marina Di Valona sh.p.k, Marina Projects Ltd, Brunos sh.p.k, Ndrejoni sh.p.k

Plan i Biznesit



Projekti Marina Di Valona



Dhjetor 2020

PERMBAJTJA

1.	PERSHKRIM I PËRGJITHSHËM I INVESTIMIT	
I.	Pershkrimi i prones dhe vendndodhja e saj.....	
II.	Permbledhje e projektit:	
III.	Vendndodhja:	
IV.	Pershkrim i Detajuar i Projektit	
V.	Vëllimet e Shkallëzuara	
VI.	Propozimet për Fazat	
VII.	Volumi i Ulët i Kalatës.....	
2.	PROGRAMI I PUNES ME AFATET E PARASHIKUARA.....	10
IV.	Zhvillimi i Marines	10
V.	Zhvillimi i Resortit Rezidencial.....	10
VI.	Zhvillimi i strukturave akomodueses shtese	11
3.	ANALIZA FINANCIARE E PROJEKTIT.....	12
I.	Ndertimi i Resortit Rezidencial.....	12



1. PERSHKRIM I PËRGJITHSHËM I INVESTIMIT

I. Pershkrimi i prones dhe vendndodhja e saj

Lloji i prones:	Truall
Adresa:	Vlore
Zhvilluesi i prones:	Bashkimi i Operatoreve Marina di Valona Sh.p.k, Marina Projects Ltd, Brunos Sh.p.k, Ndrejoni Sh.p.k – ne vazhdim Bashkimi i Shoqërive – Bashkimi i Operatoreve – Konsorcium.
Prona:	Prona eshte e vendosur ne Bashkine Vlore.

II. Permbledhje e projektit:

Projekti i propozuar nga Bashkimi i Shoqerive, synon marrjen me koncesion te Portit aktual tregtar te Vlores per ta kthyer ate ne nje Marine Turistike moderne dhe bashkekohore te shoqeruar me te gjitha insfraskrukturen perkatese per zhvillimin e plote te zones. Marina do te sherbeje per parkimin e jahteve gjate gjithë vitit duke duke ndikuar pozitivisht ne rritjen e turizmit te qytetit si dhe do te ofroje strukturat e sherbimeve mbeshtetese, zonat e rekreacionit dhe sherbimeve.

Ky projekt, eshte ne vetvete nje Projekt i Integruar ose i Perzier, i cili konsiston ne projektimin, ndertimin, financimin, operimin dhe transferimin e portit turistik "Marina Vlore" me koncesion/PPP per nje periudhe afatgjate (35 vjet) ne perputhje me Legjislacionin per Koncesionet, ne fuqi.

Konkretisht, ky projekt është i ndarë në tre komponente kryesore:

- zhvillimi i marinës i cili do të shërbej si vendparkim për yachte
- zhvillimi i hapsirave publike përreth, duke përfshire parkun dhe lidhjen me lungomaren ekzistuese
- zhvillimi i zonës komerciale dhe rezidenciale në afërsi të marinës.

Ky studim fizibiliteti fokusohet kryesisht në komponentin e tretë të sipërcituar, zhvillimin e zonës komerciale dhe rezidenciale të projektit.

Shoqëritë zhvilluese të projektit janë "Marina di Valona" sh.p.k, "Marina Projects" LTD, Brunos sh.p.k, Ndrejoni sh.p.k.

Shoqeria "Marina di Valona" sh.p.k., ka si pjese te aktivitet te saj edhe ndertimin dhe/apo administrimin e Porteve te Jahteve dhe infrastruktures mbeshtetese turistike te tyre.

"Marina Projects" Ltd, eshte nje Shoqeri nderkombetare me qender ne Mbreterine e Bashkuar, dhe me nje eksperience te gjere ne fushen e ndertimit dhe operimit te Marinave Turistike. "Marina Projects" Ltd mbulon te gjitha aspektet e zhvillimit dhe operimit te marines dhe bregdetit.

Brunos sh.p.k dhe Ndrejoni sh.p.k jane dy kompani shqipetare me experiencë të gjatë dhe aktivitet të konsiderueshëm për tregun rajonal në fushën e ndërtimit dhe importit të materialeve të ndërtimit.



Marina Di Valona sh.p.k, Marina Projects ltd, Brunos sh.p.k, Ndrejoni sh.p.k




Pamje e Portit aktual te Vlores, zona e propozuar per zhvillimin e projektit

III. Vendndodhja:

Projekti do te zhvillohet ne Portin aktual te qytetit te Vlores te shtrire ne bregdetin jugor te Shqiperise, 157 km larg pikes me te madhe kufitare me Greqine qe eshte Kakavia, rreth 140 km (75 Nm) ne vije detare me Portin e Korfuzit dhe 90 km (50 Nm) nga rajoni i Puglias ne Itali. Kufiri tokesor me Malin e Zi eshte afersisht 234 km ne veridhe hyrja ne Gjirin e Kotorrit (kufiri midis Malit te Zi dhe Kroacise) eshte rreth 130 Nm nga Vlora ne vije detare. Qyteti i Vlores eshte i favorshem edhe per shtetasit qe vijne nga Kosova pasi eshte afersisht 250 km larg nga pika doganore e Morines si edhe vetem 170 km larg nga pika doganore me Republiken e Maqedonise se Veriut. Zona perreft portit aktual te Vlores perbehet nga kater zona paresore te dallueshme qe identifikohen si:

- A. Pjesa e Plazhit ne pjesen Perendimore te Portit
- B. Porti aktual i Vlores;
- C. Shetitorja "Lungomare" pergjate bregdetit; dhe
- D. Bulevardi.



E. Figura xxx: Pozicioni i zones se projektit mbi ortofoto





Shperndarja e aktivitetit socio-ekonomik ne zonen perreth Portit

IV. Përshkrim i Detajuar i Projektit

Duke mbajtur në konsideratë pozicionimin, densitetin dhe lidhjen me pjesën tjetër urbane të qytetit të Vlorës, projekti synon të krijojë një ambient aktiv dhe atraktiv përsa i përket shërbimeve që do të ofrohen për publikun e gjerë në katin zero. Konkretisht, zona do të ketë një miks të ambienteve komerciale ku përfshihen njësi shërbimi që ofrojnë *food & beverage*, si edhe njësi tregtare retail.


Shërbimet që do të ofrohen në katin zero kategorizohen si mëposhtë:

Purpurt: Program kryesisht shërbimesh ushqim dhe pijesh në hapësirat me tarracë dhe të mirë eksponuara. Hapësira e tarracës sigurohet për të gjitha njësitë.

*Purpurt *:* Program dedikuar shërbimit luksoz të ushqimit dhe pijeve, me vendndodhje kryesisht në hapësira tarracash me pamje nga marina.

Blu: Hapësira dedikuar aktivitetete komerciale dhe tregtisë me pakicë të produkteve të luksit dhe / ose hapësirave të vogla të shërbimeve ushqim/pije përgjatë rrugës kryesore, shiritit të perëndimit të diellit dhe galerisë tregtare në terminalin e rinovuar.

Vjollcë: Hapësira potenciale tregtare me sipërfaqe më të mëdha (supermarket)



Marina Di Valona sh.p.k, Marina Projects Ltd, Brunos sh.p.k, Ndrejoni sh.p.k

Blu e hapur: Hapësirat e hollit të hotelit me programme të vogla të mundshme për tregti pakice të produkteve të luksit.

Gri: Programet e banimit / hapësirat teknike.

E zezë: Programi specifik i Marinës



V. Vëllimet e Shkallëzuara

Në krye të programit të katit përdhës, projekti zhvillon një seri vëllimesh të shkallëzuara për programin kryesisht rezidencial. Vëllimet e banimit janë rregulluar në mënyrë të tillë që të optimizojnë pamjet kundrejt marinës, gjirit të Vlorës, por edhe parkut dhe maleve në lindje.

Volumetria e planifikuar ofron hapësira të bollshme private në tarracë dhe apartamente ekskluzive si dhe një përzierje interesante të vëllimeve, tarracave dhe ballkoneve. Një përfitim i mëtejshëm tipologjisë së planifikuar është depërtimi i më shumë drite në katin e parë dhe përdorimi kolektiv kateve e para (kopshte / pishina për përdorim kolektiv të bllokut të ndërtimit - ideale për rezidenca e pushimeve)




Marina Di Valona sh.p.k, Marina Projects ltd, Brunos sh.p.k, Ndrejoni sh.p.k

Përfshirje nga programi kryesisht rezidencial janë dy programet e planifikuara hoteliere në ekstremitetet lindore dhe perëndimore të masterplanit, ndërtesa e parkimit publik në veri të rrugës hyrëse të planifikuar Transballkanike-Porti, programi i marinës së vogël dhe disa zyra të mundshme në blloqet veriore. Me përfshirje të kullës së planifikuar të hotelit, lartësia maksimale përputhet me lartësitë ekzistuese të ndërtimit përgjatë Rrugës Kosova dhe asaj Transballkanike.



Marina Di Valona sh.p.k, Marina Projects ltd, Brunes sh.p.k, Ndrejoni sh.p.k



VI. Propozimet për Fazat

